



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



## E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, mbajtur më 14.11.2022, duke filluar në orën 13:30.

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli, Ramadan Salihu, Mehreme Llumnica, Gyltene Retkoceri, Jeton Canhasi.

**Munguan:** Armend Ademi dhe Ermira Shabani.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli, kryesuese e komitetit me këtë:

## R E N D TË D I T Ë S

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Vendimi i DKA-së, i cili ka dalë në ditën e premte për kompensim të transportit;
3. Planifikimi i datës 3 dhjetor, Dita ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara;
4. Të ndryshme.

### Pika e Parë

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar**  
Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

### Pika e dytë

**Vendimi i DKA-së, i cili ka dalë në ditën e premte për kompensim të transportit**

**Fatime Demolli** kryesuese, tha se sa i përket vendimit të DKA-së, kërkesa e Komitetit ka qenë që, ndryshimi i nenit në vendimin e DKA-së, që ka të bëjë me pagesën e transportit të nxënësve me aftësi të kufizuara, që në kuadër të këtij kompensimi të përfitojnë edhe fëmijët me nevoja të veçanta në institucionet parashkollore dhe lidhur me këtë çështje, komiteti ka mbajtur takime me DKA-në.

Në këtë rast drejtoria në fakt dhe Kryetari i Komunës e ka miratuar një vendim të tillë, ku tash e tutje kompensimin prej 60 euro në muaj përveç nxënësve që janë në shkolla do të përfitojnë edhe fëmijët që janë në institucion parashkollore.

Ajo na vazhdim tha se për të fituar këtë kompensim me dashje ose pa dashje është një çeshtje që duhet të diskutohet, sepse Drejtoria e Arsimit, paraprakisht po kërkon me i vlerësua në aspektin pedagogjik fëmijët, e pastaj me ju ofrua kompensimin e transportit.

Meqenëse e pranishme ishte edhe Premtime Preniqi, kordinatore për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, kryesuesja kérkoj informata më të detajuara për mbrojtjen e të dhënave dhe të drejtave të fëmijëve dhe prindërve, pasi që prindi nëse nuk dëshiron me ju nënshtrua një vlerësimi pedagogjik, nuk duhet t'i imponohet ajo e drejtë për një kompensim.

Ajo theksoj se kjo çeshtje duhet të diskutohet tutje edhe nëpër takime me zyrtarë për gjithë përfshirje ose të vendoset një takim shtesë për me e ditë se cilat dokumente duhen. Ndërsa se a ekziston mundësia me ju paguar transporti pa pasur nevojë me ju nënshtruar vlerësimi pedagogjik, mbetet tutje me shkuar që mos me shkuar me procedura të gjata prindërit me pritë deri të vlerësohet fëmija e pastaj kompensimi.

**Ramadan Salihu**, tha se ky kusht apo kriter për vlerësim pedagogjik është tepër në këtë situatë, sepse fëmija me aftësi të kufizuara ose është me aftësi të kufizuara ose nuk është, është inteligjenca në pyetje. Nëse është i pa aftë, e ka inteligjencën e zvogëluar kështu që në procedura të rregullta menjëherë duhet të largohet si kriter, le të jetë si rekonditiv prej komitetit.

Ai në vazhdim tha se ndonëse ne bëjmë kérkesa vazhdimesh e ndoshta duken ekstreme, por ne i bëjmë sepse kemi empati në komunitetin tonë dhe i dimë hallet e tyre, por megjithatë duhet lavdëruar Komuna e Prishtinës sepse siç tha edhe Premtimja në përqindje planin e veprimit e realizon relativisht mirë.

### Pika e tretë

#### Planifikimi i datës 3 dhjetor, Dita ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara

**Fatime Demolli** kryesuese, tha se me rastin e 3 dhjetorit Ditës ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara kemi menduar me e ftuar Kryetarin e Komunës, nënkyetarët e Komunës dhe të gjithë drejtorët e drejtorive komunale në kuadër të Komunës, nga një përfaqësues të OJQ-ve, anëtarët e komitetit, se si kishim me e shënuar ditën ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara. Janë disa procedura të tjera, por mbetet të shihet se a mundë të mbahet mbledhja në Komunë apo në ndonjë hapësirë tjeter.

**Premtime Preniqi**, tha se më mirë do të ishte që mbledhja të mbahet në objektin e Komunës.

**Fatime Demolli**, shtroi pyetje për të pranishmit lidhur me organizimin e kësaj dite, a kishte me organizuar komiteti vet atë ditë apo në bashkëpunim me ndonjë drejtori, pasi që vitin e fundit Drejtoria e Arsimit, është shumë e kujdesshme, ku për secilin organizim që bënë e fton edhe komitetin tonë gjegjësisht një anëtarë apo kryesuesen e komitetit.

**Ramadan Salihu**, tha se nuk ishte kjo hera e parë që u organizua diçka për ditën ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara. Sipas vlerësimit të tij edhe të tjerat që janë mbajt kanë shkuar

shumë mirë, e tash sa marrin pjesë nuk e di, ndoshta ata që i thërrasim nuk marrin pjesë. Ai tha se për nga sasia e pjesëmarrësve ka pasur vërejtje, por për nga cilësia ka shkuar shumë mirë sa herë që e kemi organizuar si komitet.

**Fatime Demolli**, iu drejtua të pranishmëve me pyetjen se kënd mund t'i ftojmë në këtë takim.

**Premtime Preniqi**, tha se do të ishte mirë që të ftohën komplet të gjitha drejtoritë, Kryetari, dy nënkyrytarët, mund të na bashkohet edhe "Handikosi" dhe "Forumi i Personave me Aftësi të Kufizuara".

Ndërsa sa i përket kohës se mbajtjes së takimit, do të ishte mirë që takimi të mbahet prej orës 10 apo 11.

**Fatime Demolli**, tha se në mesin e të ftuarve të ftohen edhe OJQ-të, Syndrome Down Kosova, Shoqatën e të Verbërve.

Pas shumë sugjerimesh dhe propozimesh për takimin e radhës, pra për ditën ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara i cili do të mbahet me 2 dhjetor pasi që 3 dhjetori është ditë e shtunë mbetet konfirmimi nga zyrtari i OSBE-së, se ku dhe prej orës sa do të mbahet takimi.

#### **Pika e katërt**

##### **Të ndryshme**

**Premtime Preniqi**, shtroi pyetje për z. Canhasi se çka ka ndodhë me këtë parkingun që u hap tash sepse ju keni qenë në rrjedha.

**Jeton Canhasi**, tha se dikush duhet t'i kontaktoj ata sepse ky është parking privato-publik, pra privat janë këta të Marigonës, kurse publik jemi ne, që do të thotë se duhet të jetë një marrëveshje mes dy palëve.

**Fatime Demolli**, tha se me këto parkingje do të merret z. Jeton Canhasi, duke shikuar se sa parkingje janë për personat me aftësi të kufizuara dhe se do të merret me lirimin e tyre.

**Jeton Canhasi**, tha se së shpejti do të marr ndonjë informatë se a janë caktuar parkingjet e posaçme, mirëpo besoj sa ato janë përcaktuar për këtë kategori të personave.

**Gyltene Retkoceri**, tha se sa i përket parkingut, ato veç ishin të ndara, por çështja e pagesës është një çështje tjeter shumë e madhe.

**Fatime Demolli** kryesuese, tha se për këtë duhet të kontaktojmë me përgjegjësit e parkingut dhe të njoftohen edhe anëtarët e komitetit lidhur me hapat e mëtejmë për këtë çështje.

**Ramadan Salihu**, lidhur me parkingun tha se për parking duhet me bë prapë presion tek Drejtoria për Shërbime Publike dhe tek Prishtina Parking, që me u jetësua liri, me e shprehë ata edhe në praktikë vullnetin e tyre për lirim të personave me aftësi të kufizuara, pastaj çështjet teknike zgjidhen me bisedime.

- Ai në vazhdim tha se në këtë drejtim kemi edhe pjesën e kontributit që autobusët i kanë vendosur numrat zmadhues në pjesën e përparme dhe jo anash. Kjo e rrezikon personin, sepse mundohet me dalë me e shikuar numrin ndërkokë që ne si komitet e kemi shkruar se si është e duhura. Për këtë çështje do të ishte mirë të bisedohet me zyrtarët e drejtorisë përkatëse.

**Fatime Demolli** kryesuese, tha se Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar na ka ftuar me një takim në qershor, mandej prapë është shty në shtator dhe prapë nuk është mbajtur, pasi që përgjegjësja e këtij projekti ka kaluar prej asaj pozite dhe nuk ndodhet më në Forumin e Aftësisë së Kufizuar. Tash aty ka shkuan një person tjetër e që ky person më ka kontaktuar muajin e kaluar dhe i ka kërkuar kontaktet e të gjithë anëtarëve të komitetit. Edhe përkundër kontaktit me at person, deri më sot nuk na ka ftuar për ndonjë takim.

Procesmbajtësja  
Lendita Spahija

